



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 213 Akti

Nr. 283 Vendimi

Tiranë, më 29.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 27.7.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Altina Nasufi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila në seancën dëgjimore publike, të datës 27.7.2020, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Altina Nasufi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe në Këshillin e Lartë të Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4 e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina Nasufi.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe studioi të tre raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 21.11.2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari.
- v. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- vi. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit, znj. Altina Nasufi, në datën 6.7.2020, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën e hetimit dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016.
- vii. Në datën 6.7.2020, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën – për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje

me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.

- viii. Pasi u njoh me dosjen, subjekti i rivlerësimit paraqiti brenda afatit të caktuar shpjegimet e shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- ix. Në datën 23.7.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 27.7.2020, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin e Komisionit, znj. Altina Nasufi, ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, të cilat i ka paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacion provues përkatës.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 27.7.2020 u mbyll, për të rifilluar më 29.7.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ); (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, së bashku me argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (viii) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mosdeklarim pasurie ndër vite dhe ka mungesë dokumentacion justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar këto pasuri:

1. Apartament banimi me sipërfaqe 67 m² në Bulqizë, z. k. ***, nr. pasurie ***, në bashkëpronësi¹, përfituar me kontratë privatizimi, me vlerë 13,044 lekë, pjesa takuese 04.11%.
2. Apartament banimi me sipërfaqe 84 m², në “****”, Tiranë, në bashkëpronësi me bashkëshortin, z. k. ***, nr. pasurie ***, me vlerë 7,400,000 lekë.
3. Apartament² banimi me sipërfaqe 58 m², në Bulqizë, në bashkëpronësi të bashkëshortit, në z. k. ***, nr. pasurie ***, përfituar me kontratë nga privatizimi, me vlerë 2,200 lekë, pjesa takuese ¼.
4. Llogari bankare në NBG në emër të shtetasit A. K. në vlerën 109,419 lekë, me burim krijimi nga shpërblimi i dhënë nga shteti për lindjen e fëmijës dhe kursimet familjare.
5. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” në emër të shtetasit A. K. në vlerën 57,780 lekë, me burim krijimi nga kursimet familjare.
6. Gjendje në llogarinë e pagës në vlerën 352,419 lekë, në “Raiffeisen Bank”.

¹ Pasuria rezultojnë të jetë ende e pandarë.

² Në deklaratën *Vetting*, për këtë pasuri, rezultojnë të këtë shënimin “harruar pa deklaruar, ndër vite, për shkak padijenje”.

RIVLERËSIMI I KRITERIT TË PASURISË

1. Apartament banimi me sip. 67 m², në Bulqizë

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003, si dhe në deklaratën *Vetting*, e përfituar me trashëgimi ligjore. Më herët, nga trashëgimlënësit ishte përfituar me kontratën e privatizimit të lidhur me Entin e Banesave Bulqizë, në datën 5.8.1993, me vlerë 13,044 lekë. Aktualisht, zotërohet në masën 04.11 % nga subjekti i rivlerësimit.
2. Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vlerë të apartamentit me sipërfaqe 67 m², me nr. pasurie ***, vlerën prej 800,000 lekësh, ndërkohë në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e privatizimit, vlera rezulton të jetë 13,044 lekë.
3. Lidhur me këtë mospërputhje në deklaram, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit me pyetësorin nr. 2, datë 17.10.2019, në përgjigje të të cilit ka sqaruar se nuk ka ruajtur dhe nuk ka administruar dokumentacion ligjor të asaj kohe për vërtetimin e vlerës së apartamentit dhe se është bazuar në deklarinim e vlerës prej 800,000 lekësh, të dhënë nga nëna e subjektit.

1.1 Për këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin në vijim:

4. ASHK-ja Bulqizë me shkresën nr. *** prot., datë 15.8.2019, informon se figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me sip.67 m² në emër të bashkëpronarëve: N. N., F. N., M. N., L. N., A. N., F. N., F. N. dhe Altina Nasufi, ku kjo e fundit rezulton bashkëpronare në masën 4.11%.
5. Kontratë për privatizimin e banesës, formulari nr. 3, datë 5.8.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale të Banesave dhe qiramarrësit H. N.³.
6. Akt noterial me nr. 238 regj, datë 7.8.1993, me shitës Ndërmarrjen Komunale Banesa Bulqizë dhe z. H. N.⁴, për shitblerjen e apartamentit në vlerën 13,044 lekë.
7. Vendimi nr. ***, regjistrit me nr. ***, datë 16.6.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, për çeljen e trashëgimisë në emër të trashëgimtarëve të H. N.⁵, si dhe vendimi nr. ***, datë 11.3.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë për korigjimin e gabimit material⁶.
8. Komisioni, pasi ka konstatuar përputhjen e deklarimeve të subjektit mbi këtë pasuri, si dhe duke mbajtur në konsideratë, veç periudhës së privatizimit në fjalë (viti 1993) edhe shumën e papërfillshme – në raport me tërësinë e vlerësimit të pasurive – por edhe të mënyrës së krijimit (nëpërmjet trashëgimisë) së pasurisë në fjalë, ka konkluduar për moskonstatim të problematikave lidhur me të. Ndërsa mbi çmimin e deklaruar, Komisioni i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

2. Apartament banimi me sip. 84 m², në “***”, Tiranë

³ Babai i subjektit të rivlerësimit.

⁴ Emri në kontratë rezulton të jetë H. dhe jo H.

⁵ Në të është vendosur se bashkëshortja dhe fëmijët e të ndjerit H. N. përfitojnë nga 1/8 pjesë secili të pjesës së tij. Konstatohet se në faqen e parë të vendimit emrin i subjektit të rivlerësimit rezulton të jetë shënuar Altin Nasufi, ndërsa në faqen e dytë është shënuar Altina.

⁶ Vendimi nr. ***, nr. *** akti, datë 11.3.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë për ndreqje gabimi material pasi në vendimin e zbardhur nuk ishin shënuar emrat e 3 prej trashëgimtarëve.

9. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2006 dhe më pas në deklaratën *Vetting*, në bashkëpronësi me bashkëshortin⁷, me sip. 84 m², në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në “****”, Tiranë.
10. Si burime të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- i. bonot e thesarit të vjehrrit, z. G. K., në shumën 3,500,000 lekë, të depozituara në vitin 2003 në Bankën e Shqipërisë dhe të dhuruara bashkëshortit, së bashku me interesat;
 - ii. hua nga familjarët e bashkëshortit në shumën 27,000 euro (nga të cilat 5,000 euro falur/dhuruar);
 - iii. kursime nga paga e bashkëshortit, në shumën 400,000 lekë;
 - iv. kursime nga paga të subjektit të rivlerësimit (pa u specifikuar shuma përkatëse).
11. Në deklaratën *Vetting*, vlera e deklaruar e kësaj pasurie është 7,400,000 lekë, çmim ky që përkon me atë të referuar në kontratën e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2009, me palë blerëse E. K. e Altina Nasufi dhe palë shitëse B. M.
12. Rezulton se më parë për këtë pasuri, është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes⁸ me nr. *** rep, nr. *** kol, datë 10.11.2005, e lidhur ndërmjet sipërmarrësit “****”⁹ sh.p.k., dhe porositësit E. K., në të cilën është rënë dakord për çmimin e apartamentit 750 euro/ m², në vlerën totale 67,500 euro.¹⁰
13. Përgjatë hetimit administrativ, nuk ka rezultuar ekzistenca e ndonjë aktmarrëveshjeje me shoqërinë ndërtuese, për modifikimin e elementëve të kontratës së porosisë/sipërmarrjes, dhe specifikisht lidhur me ndonjë ndryshim të mundshëm të çmimit të blerjes së apartamentit në fjalë, ndonëse është konstatuar një mospërputhje midis çmimit të dakordësuar fillimisht, në shifrën 67,500 euro (ose 8,271,450 lekë) dhe çmimit të deklaruar sipas kontratës në shumën prej 7,400,000 lekësh.
14. Nga përmbajtja e kontratës së sipërmarrjes ka rezultuar se vlera monetare prej 28,000 euro i është likuiduar shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., në momentin e nënshkrimit të saj¹¹. Kjo shumë është paguar në datën 9.11.2005, nga të cilat 21.911 euro janë transferuar në

⁷ Subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me shtetasin E. K. në datën 16.8.2005.

⁸ Referuar kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2005, neni 2, rezulton se: “Porositësi i likuidon sipërmarrësit në momentin e firmosje shumë prej 28,000 euro, dhe pjesa tjetër do të likuidohet në momentin e dorëzimit fizik të apartamentit”.

⁹ Komisioni i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibrës, për të verifikuar ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, nëse gjatë ushtrimit të detyrës funksionale, si relatore apo anëtare e trupës gjyqësore, ka pasur çështje gjyqësore ku si palë të ketë qenë shoqëria ndërtuese “Perxhola” sh.p.k., dhe nga dokumentacioni dhe vërtetimet e vëna në dispozicion nuk rezultoi që subjekti të ketë shqyrtuar çështje me këtë shoqëri ndërtuese.

¹⁰ Me kursin e këmbimit mesatar të fundit të vitit 122.54 rezulton se shuma 67,500 euro konvertohet në 8,271,450 lekë.

¹¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 17.10.2019, subjekti ka vënë në dispozicion mandatarkëtimet për shlyerjen e shumë: mandatarkëtimin nr. ***, datë 14.9.2007, paguar 5,000 euro; mandatarkëtimin nr. ***, datë 15.2.2007, paguar 10,000 euro; mandatarkëtimin nr. ***, datë 27.12.2006, paguar 3,500 euro; mandatarkëtimin nr. ***, datë 20.8.2006, paguar 10,000 euro; mandatarkëtimin nr. ***, datë 30.5.2006, paguar 5,500 euro; mandatarkëtimin, datë 15.2.2006, paguar 5,500 euro; mandatarkëtimin nr. ***, datë 9.11.2005, paguar 6,100 euro; si dhe shumën prej 21.911.37 euro në vitin 2005 të paguar nga llogaria bankare e shtetasve Ll. N. dhe E. K. në “Raiffeisen Bank”, pra, në total 67,511 euro.

llogari të z. P. G.¹² nëpërmjet llogarisë së përbashkët bankare dhe shuma prej 6,100 euro rezulton të jetë likuiduar *cash* në arkën e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.

15. Në DIPP-në e vitit 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhjen e kontratës së sipërmarrjes të sipërcituar (të pa deklaruar në vitin pararendës) dhe pagesat e kryera në favor të shoqërisë ndërtuese, por nuk ka specifikuar burimin e krijimit të shumave të paguara. Ndërkohë, deklaratës së vitit 2006, subjekti i ka bashkëlidhur një shtojcë të titulluar “*sqarime plotësuese*”¹³, në të cilin ka saktësuar se deri në fund të vitit 2006 kishte likuiduar shumën prej 52,500 euro për porositjen e apartamentit në fjalë, nga të cilat 27,000 euro janë marrë hua personave të afërt dhe 3,000,000 lekë rrjedhin nga bonot e thesarit në emër të bashkëshortit të subjektit.
16. Pasi Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit që të sqaronte dhe të provonte me dokumentacion mënyrën e kryerjes së këtyre pagesave dhe të burimit të ligjshëm të të ardhurave të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se motra e bashkëshortit, znj. Ll. N. (K.) i ka ndihmuar duke iu dhënë hua në shumën totale 27,000 euro, nga të cilat 21,900 euro janë marrë nga llogaria e saj bankare dhe pjesa tjetër prej 5,100 euro iu është dhënë *cash* në prill të vitit 2006. Shuma prej 6,100 euro kanë qenë të ardhura të kursyera nga paga e saj dhe e bashkëshortit ndër vite. Ndërsa për shlyerjen e shumës prej 24,500 euro në vitin 2006, kanë shërbyer këto burime:
 - i. arkëtimet nga bonot e thesarit, datë 8.12.2005, në vlerën 397,013 lekë;
 - ii. të ardhura nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit përgjatë vitit 2006;
 - iii. hua pa interes nga motra e bashkëshortit, znj. Ll. N., në vlerën 5,100 euro dhënë *cash* (dorazi);
 - iv. të ardhura nga bonot e thesarit në vlerën 566,911 lekë, të arkëtuara në datën 9.2.2006;
 - v. të ardhura nga bonot e thesarit në vlerën 1,044,269 lekë, të arkëtuara në datën 17.8.2006.
17. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kryerjen e pagesës prej 15,000 euro, me përshkrimin: “*shlyer plotësisht detyrimin ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.*”.
18. Nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 17.10.2019, subjekti ka shpjeguar se për shlyerjen e shumës prej 15,000 euro në vitin 2007 kanë shërbyer: (i) arkëtimet nga bonot e thesarit në vlerën 1,269,321 lekë, datë 7.2.2007; (ii) arkëtimet nga bonot e thesarit në vlerën 747,422 lekë, datën 2.8.2007; (iii) të ardhura nga paga e subjektit përgjatë vitit 2007; dhe (iv) të ardhura nga paga e bashkëshortit të subjektit, z. E. K., përgjatë vitit 2007.

2.1. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:

19. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2017, ZQRPP-ja Tiranë dhe me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2020, ASHK-ja Tiranë Veri, ka konfirmuar pasurinë e paluajtshme të llojit

¹² Përfaqësues ligjor i shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. Në përshkrim të transfertës është shënuar mbiemri A..

¹³ Dokumenti mban datën 6.11.2007 dhe i është bashkëngjitur deklaratës periodike të vitit 2006, por nuk rezulton të jetë i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

apartament me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, regjistruar në emër shtetasës Altina Nasufi dhe bashkëshortit.

20. Kontratë sipërmarrjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2005, për ndërtimin e apartamentit me sipërfaqe ndërtimi 81.2 m², plus 8.8 m², me vlerë 67,500 euro, ku shuma prej 28,000 euro likuidohet me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes.
21. Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2009, nënshkruar mes palës shitëse z. B. M.¹⁴, dhe palës blerëse, z. E. K. dhe znj. Altina Nasufi, për blerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqes prej 84 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, nga ku rezulton se çmimi i shitjes, i caktuar në shumën 7,400,000 lekë, ishte likuiduar jashtë zyrës noteriale.
22. Certifikatë për vërtetimin e pronësisë nr. ***, z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në emër të shtetasve E. K. dhe A. N., lëshuar në datën 1.12.2009.
23. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.2014, nga ku rezulton se deklaruesi G. K. (babai i bashkëshortit), i ka dhuruar bonot e thesarit në shumën 3,400,000 lekë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit (djalinë të tij), në vlerën e vitit 2005, për pagesën e kësteve të shtëpisë në Tiranë.
24. Mandatpagesa e këstit të parë të blerjes së apartamentit, datë 9.11.2005, me përshkrimin “*likuidim i këstit të parë të shtëpisë*”, në vlerën 21,911 euro nga llogaria e përbashkët Ll. N. dhe E. K.
25. Me shkresën, nr. *** prot., datë 1.8.2019, OSHEE-ja ka konfirmuar kontratën e furnizimit në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. E. K.
26. Komisioni – duke mbajtur në konsideratë të gjitha materialet e administruara, si dhe qëndrimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me rrethanat specifike që ndikojnë në vlerësimin e të ardhurave objekt shqyrtimi – analizoi veçmas secilin prej burimeve financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, ku rezultoi si vijon:

2.2 Lidhur me shumën 3,400,000 lekë

27. Kjo shumë është deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri, e përshkruar si e përfituar prej dhurimit (në formën e bonove të thesarit) nga babai i bashkëshortit¹⁵ të subjektit.
28. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, në emër të bashkëshortit, në vlerën 3,000,000 lekë, me burim të krijimit nga kursimet.
29. Me shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 30.7.2019, të Bankës së Shqipërisë ka rezultuar se bonot e thesarit në emër të shtetasit G. K. në vlerën prej 3,500,000 lekësh ishin depozituar në datat 3.2.2005 dhe 2.2.2006, kur kishte përfunduar afati i depozitimit një

¹⁴ Z. B. M., përfaqësohet në kontratën e shitblerjes me prokurë nga z. P. G.

¹⁵ Bazuar në pikën 14, të nenit 3 dhe në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, prindërit e bashkëshortit të subjektit, plotësojnë kriteret ligjore për t'u kualifikuar si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, ndaj subjektit lind detyrimi për të provuar gjendjen pasurore dhe burimet e ligjshme të tyre për të justifikuar ligjshmërinë e shumave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit.

vjeçar dhe pasi këto fonde janë tërhequr, rezulton që, po në këtë datë, të jetë depozituar nga z. E. K., shuma prej 3,000,000 lekësh, në llogaritë tij.

30. Lidhur me vlerësimin e burimit të ligjshëm të mundësisit të kursimit të kësaj shume, Komisioni i është drejtuar subjektit të rivlerësimit për qartësime të mëtejshme, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, datë 17.10.2019. Në përgjigje të tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma prej 3,000,000 lekësh përfaqëson një pjesë të kursimeve të familjes së origjinës së familjes së bashkëshortit, të cilët të gjitha kursimet si para viteve 1990 ashtu edhe pas viteve 1990 i kanë depozituar në këtë bankë. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka depozituar dokumentacion provues¹⁶, lidhur me depozitat e kursimit në emër të vjehrrit, z. G. K., si dhe ka sqaruar se ky ka qenë, në mënyrën e perceptimit të saj, një investim i përbashkët familjar, pjesë e të cilit ka qenë edhe bashkëshorti i saj.
31. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion të Komisionit vërtetimin nr. *** prot., datë 21.10.2019, të lëshuar nga “Raiffeisen Bank” lidhur me depozitat e kursimit në ish-Bankën e Kursimeve. Referuar këtij vërtetimi rezulton se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë pasur depozita kursimesh në këtë bankë, të çelura nga viti 1995 dhe 1996 me të dhënat, si vijon:
 - i. Depozitë kursimi, nr. ***, në emër të shtetasve E. K. dhe J. (G.) K. çelur më 26.7.1995 në shumën 220,200 lekë dhe mbyllur më 31.7.1996, në shumën 1,446,011 lekë.
 - ii. Depozitë kursimi, nr. ***, në emër të shtetasit J. (G.) K. çelur më 25.5.1996, në shumën 359,158 lekë dhe mbyllur më 4.2.2003, në shumën 1,967,008 lekë.
32. Në pyetësorin nr. 4, datë 27.2.2020, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të informojë dhe të shpjegojë bindshëm nëse fondet e sipërpërmendura, pas datave të maturimit (si më lart), kanë qenë të (ri)depozituara në ndonjë bankë/institucion tjetër financiar, si dhe nëse në kohën e ndërmjetme – pas maturimit dhe tërheqjes së tyre – është kryer ndonjë tjetër investim nga babai i bashkëshortit.
33. Në përgjigje të sa më lart, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2020¹⁷, ku ka dhënë informacion mbi veprimet financiare si kreditorë të shtetasve G. dhe E. K. në ish-firmën piramidale “***” sh.p.k. Nga kjo shkresë konfirmohet se në datën 19.8.1996, zj. E. K. ka depozituar vlerën prej 1,500,000 lekësh¹⁸ te shoqëria “***” sh.p.k. dhe më pas nuk rezulton të jetë tërhequr ndonjë shumë

¹⁶ Nga shqyrtimi i pasqyrës elektronike të Bankës së Shqipërisë së depozituar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, duket se lëvizjet e 3 llogarive të shtetasve G. K. dhe E. K. janë në vijim të njëra-tjetrës. Më konkretisht, investimi fillestar i shumës prej 3,500,000 lekësh nga shtetasi G. K. është kryer në datën 2.2.2005, për të cilën ka marrë dhe interesin paradhënie prej 257,831 lekë. Në datën 2.2.2006 (në të cilën E. K. investon 3,000,000 Lekë) është mbajtur tatimi (në maturim) për interesin e marrë më parë paradhënie nga z. G. K. prej 25,783 lekësh, si dhe është përfutur interesi i investimit të ri nga E. K. paradhënie prej 93,694 lekësh. Nga të gjitha këto veprime bashkë është bërë tërheqja e shumës prej 566,911 lekësh (si neto e veprimeve të të dyja llogarive) dhe është bërë investimi i shumës së mbetur prej 3,000,000 lekësh nga z. E. K. Gjithashtu, në fund të kësaj pasqyre, rezulton shënimi “datë 2.2.2006 në të cilën kthehet vlera nominale për ank. 990 ka kaluar nga G. K. tek E. K., janë veprimet më sipër për E. K.”.

¹⁷ Lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëritë huamarrëse në administrim.

¹⁸ Shuma prej 1,500,000 lekësh rezulton të jetë depozituar 19 ditë pas tërheqjes së shumës prej 1,446,011 lekësh nga ish-Banka e Kursimeve.

monetare¹⁹. Gjithashtu, konfirmohet se z. G. K. ka depozituar në datën 19.4.1996, shumë prej 150,000 lekësh te shoqëria “***” sh.p.k. dhe më pas rezultojnë të ketë tërhequr vetëm interesat e depozitave, në shumë totale prej 94,700 lekësh²⁰.

34. Lidhur me burimin e këtyre shumave të depozituara, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 17.10.2019, dokumentacionin që vërteton periudhën e punësimit të familjes së bashkëshortit²¹, si dhe të ardhurat e përfituara nga pensioni për prindërit e bashkëshortit të subjektit²².
35. Nga përllogaritja e të ardhurave të familjes së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar, si vijon:
- i. në periudhën 1989 – 30.6.1995, të ardhurat kanë qenë në vlerën 433,477 lekë dhe mundësia e kursimit ka qenë 130,043 lekë;
 - ii. në periudhën 1.7.1995 – 30.4.1996, të ardhurat kanë qenë në vlerën 261,034 lekë dhe mundësia e kursimit ka qenë 144,600 lekë;
 - iii. në periudhën 1.5.1996 – 2004 të ardhurat kanë qenë në vlerën 3,581,644 lekë dhe mundësia e kursimit ka qenë 1,361,059 lekë.
36. Në tabelën më poshtë është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur përllogaritja e burimeve të të ardhurave²³ të familjes së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit:

Të ardhura nga pensionet (maj 1996 – 2004)	2 129 313
Të ardhura nga pagat (maj 1996 – 2004)	1 452 331
Shpenzimet e jetesës	-2 220 586
Mundësia e kursimit nga të ardhurat	1 361 059
Depozita në Raiffeisen Bank (tërhequr në 2003)	1 967 008
Mundësia e disponibilitetit në 2005	3 328 067

37. Në këtë analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat nga: (i) pensionet e z. G. K. dhe të znj. E. K.; (ii) paga e znj. Ll. K. deri në vitin 1997²⁴; dhe (iii) paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2002²⁵. Ndërkohë që lidhur me të ardhurat e tërhequra nga llogaria e mbyllur në datën 31.7.1996 në shumë 1,446,011 lekë, Komisioni ka vlerësuar të mos i konsiderojë dhe përllogarisë si një burim për gjenerimin e kursimeve të zotëruara në vitin 2005, për sa kohë rezultojnë se shuma përkatëse është depozituar në

¹⁹ Sipas kartelës së kreditorit, E. ka tërhequr interesa në shumë përkatësisht: 240,000 lekësh në datën 19.10.1996; 278,400 lekë në datë 19.12.1996; si dhe depoziton sërish pas marrjes së interesave pothuajse të njëjtat shuma prej përkatësisht 240,000 lekësh më 19.10.1996 dhe 280,000 lekësh më 19.12.1996.

²⁰ Sipas kartelës së kreditorit, G. ka tërhequr interesat përkatësisht në shumë: 22,700 lekë, datë 19.6.1996; 24,000 lekë, datë 19.8.1996; 24,000 lekë, datë 19.10.1996; dhe 24,000 lekë, datë 19.12.1996.

²¹ Vërtetim nr. ***, datë 12.4.2019, lëshuar nga ISSH-ja për të ardhurat e realizuara nga znj. Ll. K. për periudhën 1.1.1994 – 30.8.1998 dhe vërtetim nr. *** prot., datë 27.10.2016, për të ardhurat e realizuara nga z. E. K. nga data 1.2.1996.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2019, të lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Dibër, nga ku vërtetohet se shtetasi G. K. për periudhën nga 1.9.1991 deri në vitin 2019, si edhe shtetasja E. K., për periudhën nga 24.9.1989 deri në vitin 2019, janë trajtuar me pension pleqërie.

²³ Të ardhurat e familjes që rrjedhin nga pensionet e prindërve të bashkëshortit të subjektit, të ardhurat nga pagat e shtetasve E. K. dhe Ll. N. (K.) dhe depozita e tërhequr në vitin 2003.

²⁴ Pasi rezultojnë të jetë martuar në 1998 dhe emigruar në Greqi.

²⁵ Pasi në vitin 2003, z. E. K. transferohet në Tiranë.

shoqërinë “***” sh. p.k., në datën 19.8.1996, dhe nuk rezulton të jetë tërhequr, veç interesave të sipërcituar.

38. Lidhur me të ardhurat e tërhequra nga llogaria e mbyllur në datën 4.2.2003, me gjendje shumë prej 1,967,008 lekësh, ka rezultuar se nuk është provuar me dokumente ligjore që personat e tjerë të lidhur, të kenë pasur mundësi për të kursyer të gjithë shumën e depozituar prej tyre në vitin 1996 (prej 359,158 lekë)²⁶ me burime të ligjshme financiare dhe njëkohësisht të përballonin shpenzimet jetike²⁷ gjatë këtyre viteve. Nisur nga fakti se periudha e depozitimit të fondeve në vitin 1996, i referohet periudhës përpara lidhjes së martesës ligjore, si dhe përpara fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, si dhe duke mbajtur në vëmendje faktin që mungesa financiare e paprovuar është minimale dhe i përket një periudhe shumë të hershme, Komisioni, mbështetur në parimin e objektivitetit, e vlerësoi si një burim të ligjshëm, dhe e konsideroi në analizë financiare, këtë depozitë, në shumën prej 1,967,008 lekësh, për krijimin e kursimeve prej familjes së bashkëshortit në vitin 2005, për sa kohë rezulton e provuar se ato shuma ekzistonin në një depozitë bankare të shtuara, ndër vite, nga interesat dhe përjashtojnë çdo dyshim të përfshirjes së ndonjë kontributi të subjektit të rivlerësimit për gjenerimin e tyre.
39. Në vijim dhe në konsideratë të sa më lart, duke pasur në vëmendje se burimet e ligjshme të të ardhurave të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar të mjaftueshme për të mundësuar kursimin e të gjithë shumës prej 3,400,000 lekësh, të deklaruar para noterit, si të dhuruar në favor të këtij të fundit, Komisioni mori në konsideratë, përgjatë përlogaritjes së analizës financiare të subjektit, vetëm shumën prej 3,000,000 lekësh, e cila është objekt analize, për sa kohë është investuar prej tij në bono thesari në vitin 2006, dhe është përdorur më pas për blerjen e kësaj pasurie, si dhe interesat e tërhequra²⁸ më pas nga z. E. K., pasi edhe këto shuma rrjedhin nga një burim i ligjshëm dhe janë të provuara nga veprimet bankare edhe lidhur me kalimin e tyre nga llogaria bankare në favor/posedim të këtij të fundit. Në vijim të analizës së të dhënave të mësipërme, në lidhje me këtë burim, ka rezultuar se provohet ligjshmëria dhe mjaftueshmëria mjeteve monetare të përdorura.

2.3 Lidhur me huan e marrë në vlerën 27,000 euro, nga motra e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ll. N.²⁹

40. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë një hua në vlerën 27,000 euro nga shtetasja Ll. N.³⁰, me burim nga kursimet e përfituara nga punësimi dhe familja e saj e origjinës në Shqipëri, si dhe nga puna e familjes së saj në shtetin grek. Kjo

²⁶ Referuar pikës (b) më lart: në periudhën 1.7.1995 – 30.4.1996, të ardhurat kanë qenë 261,034 lekë dhe mundësia e kursimit ka qenë 144,600 lekë.

²⁷ Këto shpenzime janë llogaritur nga periudha 1989 – 1997 në masën 70 % të të ardhurave dhe më pas janë llogaritur sipas të dhënave të INSTAT.

²⁸ Interesat e tërhequra paradhënie nga bashkëshorti E. K., pas zbritjes së tatimeve përkatëse të mbajtura nga Banka e Shqipërisë kanë qenë përkatësisht në shumën 138,963 lekë në vitin 2006 dhe në shumën 17,743 lekë në vitin 2007.

²⁹ Bazuar në nenet 3, pika 14 dhe në nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, shtetasja Ll. N. dhe bashkëshorti plotësojnë kriteret ligjore për t'u kualifikuar si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, ndaj subjektit lind detyrimi për të provuar gjendjen pasurore dhe burimet e ligjshme të tyre për të justifikuar ligjshmërinë e shumave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit.

³⁰ Kjo hua është deklaruar për herë të parë në nëntor të vitit 2007, në një dokument i pa nënshkruar nga deklaruesi, pa nr. protokollit dhe pa vulën e ILDKPKI-së, me titull *sqarime plotësuese* për DIPP-në e vitit 2006.

hua është shlyer, ndër vite, me përjashtim të shumës prej 5,000 euro (pjesë përbërëse e huas), e cila është falur/dhuruar nga pala huadhënëse. Këtë rrethanë subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*, ku ka specifikuar se nga totali i huas në fjalë, shuma prej 5,000 euro është falur nga huadhënësi.

41. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerje të huas duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2008 deri në DIPP-në të vitit 2011. Lidhur me mosdeklarimin ndër vite të faljes së shumës prej 5,000 euro, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se arsyeja e mosdeklarimit është një harresë e saj, duke e konsideruar si të përfunduar detyrimin monetar ndaj të tretëve.
42. Lidhur me disa diferenca të konstatuara nga Komisioni midis përmbajtjes së deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2014, të lëshuar nga shtetasja Ll. N.³¹, deklarimeve të subjektit ndër vite, si dhe në deklaratën *Vetting*, Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, që të shpjegonte bindshëm këtë mospërputhje. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka shpjeguar se përpara përpilimit të deklaratës noteriale të datës 11.9.2014, detyrimi i fundit i mbetur, ishte në vlerën 10,000 euro. Në këto kushte, subjekti ka sqaruar se në këtë deklaratë nisur edhe nga distanca në kohë, ndërmjet mbylljes së huas dhe deklaratës noteriale, nga bashkëshorti ka një gabim në deklarim, duke deklaruar që huaja është shlyer brenda vitit 2010, ndërkohë që në vitin 2011, ka deklaruar shlyerjen e huas në shumën 2,500 euro dhe detyrim të mbetur në shumën 10,000 euro. Ky deklarim përbën një lapsus nga ana e tij, pasi znj. Ll. N. në të njëjtën deklaratë flet për një detyrim të mbetur në shumën 10,000 euro dhe se ajo heq dorë nga shuma 5,000 euro, shumë e cila është dhuruar. Subjekti ka shpjeguar se kjo deklaratë noteriale, e hartuar disa vite me pas, në vitin 2014, ka pasur për qëllim të dokumentojë marrëdhënien e huas dhe të tregojë që nuk ka më asnjë detyrim kundrejt shtetasës Ll. N. (K.) dhe se mospërputhja në deklarim për kohën e likuidimit të huas, vjen nga fakti i kalimit të një kohe relativisht të gjatë nga koha e shlyerjes dhe për shkak të faktit që marrëdhënia e huas dhe e likuidimit të saj nuk ka qenë e dokumentuar.
43. Për sa i takon burimit të ligjshëm, që ka mundur shlyerjen e huas nga subjekti i rivlerësimit, është deklaruar me burim nga të ardhurat nga punësimi, nga pagat dhe pagesat e kryera janë përfshirë në analizën financiare, ku ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshmëri financiare.
44. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se shuma prej 21,911.37 euro (si pjesë përbërëse e huadhënies në shumën prej 27,000 euro), është transferuar nga llogaria e përbashkët e shtetasve Ll. N. dhe E. K., por në këtë llogari nuk evidentohet se kush ka bërë derdhjet e shumave dhe cili ka qenë burimi i krijimit të tyre, kush prej bashkëtitullarëve të llogarisë në fjalë kishte kontribuar në depozitimin e tyre dhe në çfarë mase, ndërsa shuma e dytë prej 5,100 euro është deklaruar që është marrë *cash*. Subjekti shpjegoi se shumat në fjalë ishin të gjitha kursime të familjes së motrës (huadhënësve), të cilat ishin depozituar në bankë dy vite përpara se të martohej dhe se llogaria dyemërore ishte hapur, pikërisht, për

³¹ Nëpërmjet kësaj deklarate konfirmohet marrëdhënia financiare në fjalë edhe nga pala huadhënëse.

të mundësuar kryerjen e veprimeve bankare nga z. E. K., kur huadhënësit gjendeshin jashtë vendit, për sa kohë ata prej vitesh jetonin dhe punonin në shtetin grek.

45. Konkretisht, lidhur me këtë pikë, subjekti ka shpjeguar se shuma e depozituar në këtë llogari në “Raiffeisen Bank”, që ka shërbyer për shlyerjen e këstit të parë për blerjen e apartamentit, përfaqëson një pjesë të kursimeve të motrës së bashkëshortit, znj. Ll. N. dhe se kjo depozitë është çelur në datën 10.10.2003, rreth dy vite përpara lidhjes së martesës ligjore dhe fillimit të bashkëjetesës me shtetasin E. K. Referuar statement të lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, arkëtimi i parë në shumën 11.000 euro në datën 10.10.2003 është bërë nga motra e bashkëshortit, znj. Ll. N., kohë në të cilën ajo kishte ardhur në Shqipëri. Shënimi edhe i emrit të vëllait të saj të vetëm z. E. K. është bërë vetëm për arsye të lehtësisë së kryerjes së veprimeve bankare te depozitimit të kursimeve të saj nga puna në emigracion në shtetin grek, për shkak të vonesave që mund të kishte në rinovimin e lejeve e qëndrimit në këtë shtet. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti shtoi edhe faktin se në të njëjtën datë, 10.10.2003, motra e bashkëshortit, znj. Ll. N. ka çelur edhe një llogari tjetër në “Alpha Bank”, me arkëtimin prej saj të shumës 500 euro, shumë e cila përfaqëson kursime të saj. Edhe kjo llogari vetëm për lehtësi të kryerjes së veprimeve bankare është dy emërore, pra, është shtuar edhe emri i bashkëshortit E. K.
46. Trupi gjykues, nisur nga situata faktiko-ligjore në vlerësim, duke analizuar dinamikën e këtyre veprimeve bankare, si dhe kohën e kryerjes së tyre – midis dy personave që gjenden/shin në një marrëdhënie të veçantë (vëlla e motër) – shumë më e hershme nga nisja e bashkëjetesës apo martesës së subjektit me të vëllanë e huadhënëses Ll. N., i çmon të besueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.
47. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit duke i kërkuar shpjegime edhe mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të motrës së bashkëshortit, për dhënien e huas në shumën prej 27,000 euro, si dhe e ftoi që të provojë me dokumentacion ligjor këtë burim. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka vendosur në dispozicion disa vërtetime të lëshuara nga autoritetet greke³², ku rezultojnë të pasqyruara të ardhurat dhe shuma e kontributeve të mbuluara me sigurime shoqërore, për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2005. Për vitet e siguruara: 1998, 1999, 2000 dhe 2001 është paraqitur librezë e kontributeve të sigurimit së bashku me lejet e qëndrimit, si dhe dokumentacion i noterizuar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe. Nga ky dokumentacion i paraqitur, konstatohet se z. P. N. (bashkëshorti i Ll. N.) për periudhën 1998 – 2005 ka realizuar të ardhura totale në vlerën 40,218.75 euro³³. Ndërkohë, duke huazuar shumën prej 27.000 Euro, familjes së huadhënësve për këto 8 vjet (1998–2005) u kanë mbetur vetëm 13,218.75 euro për përbalimin e shpenzimeve jetike (në Greqi), për të njëjtën periudhë.
48. Komisioni, në konkludim të fazës hetimore e ftoi sërish subjektin e rivlerësimit që të shpjegonte bindshëm burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua prej 27,000 euro në raport me vlerën e të ardhurave prej 40,218.75 euro dhe mjaftueshmërinë për të përbaluar

³² Vërtetim, datë 16.4.2019, lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e shtetit Grek (dokument me vulë apostile), i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe

³³ Të ardhurat nga punësimi rezultojnë në shumën 27,278.87 euro (periudha 2002 – 2005) + 3,467,035 dhrahmi (periudha 1998 – 2001). Ndërkohë sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 26.11.2003 rezulton se shtetasi P. N. është subvencionuar për shkak të papunësisë për 210 ditë në vitin 2003, në vlerën 2,765.16 euro.

me pjesën e ngelur shpenzimet jetike, si dhe shpenzimet e tjera të familjes së huadhënësit, përgjatë periudhës 1998 – 2005.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

49. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit lidhur me këtë pikë nëpërmjet prapësimeve, veç të tjerash, ka shprehur se:

[...] në analizën financiare të bërë nga Komisioni për shumën e marrë hua prej 27,000 euro në raport me vlerën e të ardhurave 40,218.75 euro dhe mjaftueshmërinë për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera të familjes së huadhënësit, përgjatë periudhës 1998 – 2005, nga dokumentacioni i depozituar, provohet që çifti i bashkëshortëve Ll. dhe P. N. e përligjin në mënyrë të arsyeshme dhënien hua të shumës prej 27.000 euro, pasi me të ardhurat e siguruara nga puna edhe në emigracion, tregojnë se kanë pasur mundësi financiare edhe të kursejnë duke depozituar në bankë një pjesë të konsiderueshme të shumës që iu është dhënë hua. Me të ardhurat e tjera, ata kanë përballuar mjaftueshëm jetesën e tyre me shpenzime modeste në shtetin grek. Subjekti ka shtuar se do të ishte e pamundur një përlllogaritje e saktë e të ardhurave neto të një familje emigrantësh sidomos në shtetin grek, për shkak të specifikave të emigracionit në këtë shtet, që lidhen me periudhën e pajisjes me dokumentacion të rregullt qëndrimi për emigrantët, punësimin e rregullt edhe pse me dokumentacion të rregullt qëndrimi, gjë që nuk varej nga vullneti dhe dëshira e bashkëkombësve tanë, si dhe lloji i punës i kryer. Për të gjitha këto specifika, nisur edhe nga distanca e largët në kohë për periudhën për të cilën është kërkuar shpjegim (1998 – 2005), pavarësisht gjithë dëshirës dhe vullnetit për të qenë bashkëpunuese në interes të saj, subjekti deklaroi se e ka të pamundur të paraqesë një përlllogaritje të shpenzimeve për jetesë të tyre dhe të bëjë një përlllogaritje të ardhurave neto të kursyera nga kunata dhe bashkëshorti i kësaj të fundit.

Gjithashtu, subjekti ka cituar se pozitën juridike të personave të tjerë të lidhur në raport me subjektin e rivlerësimit për provueshmërinë e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë, e ka analizuar Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin nr. 15, datë 17.07.2019 duke vendosur këtë standard: “[...] Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj pasurie konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai është ngarkuar ligjërisht të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur [...]”.

Në këtë shpjegim, në drejtim të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të shumës së dhënë hua nga personi tjetër i lidhur, ka cituar, po ashtu edhe pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, ku një nga parimet mbi bazën e të cilit kryhet procesi i rivlerësimit është ai i proporcionalitetit. Sipas nenit 52 të këtij ligji në lidhje me standardin procedural të barrës së provës, Komisioni dhe Kolegji i Apelimit udhëhiqen nga parimi i objektivitetit

dhe proporcionalitetit. Për kryerjen sa më korrekt të procesit të kontrollit të pasurisë, ligjvënësi, por edhe vetë Komisioni nëpërmjet parimit të proporcionalitetit pranojnë zgjidhjen e çështjeve dhe marrjen e vendimeve duke pasur në konsideratë gjendjen që e dikton këtë vendimmarrje dhe ka kërkuar që të analizohet ky parim edhe në këndvështrim të zhvillimit historik dhe ekonomik të vendit tonë, situatës së informalitetit të krijuar, ndër vite, për shkak të rrethanave specifike të zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike dhe specifikisht, remitançave të përftuara nga emigracioni.

Në përfundim të sa më sipër, subjekti pohoi se shuma e dhënë hua prej 27.000 euro prej personit tjetër të lidhur, provohet se është krijuar me burim financiar të ligjshëm. Kështu vërtetohet se para emigrimit në shtetin grek, bashkëshortët Ll. dhe P. N., kanë përfituar të ardhura në mënyrë të ligjshme nga marrëdhëniet e punës në Shqipëri si inxhinierë. Në vijim, për periudhën 1998 – 2005 nga dokumentet e lëshuara nga autoritetet greke rezulton se për vitet 1998 – 2005 është provuar vlera e të ardhurave 40,218,75 Euro [...].

50. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, në cilësinë e provave shkresore, këto dokumente:

- i. Vërtetim nr. *** prot., datë 9.5.2019, lëshuar nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore Bulqizë, për të ardhurat nga punësimi në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë për periudhat 5.7.1988 – 15.8.1988 dhe 8.9.1989 – 31.12.1993, të znj. Ll. K. (N.).
- ii. Vërtetim nr. *** prot., datë 12.4.2019, lëshuar nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore Bulqizë, për të ardhurat nga punësimi në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë për periudhën 1.1.1994 – 30.8.1998, të znj. Ll. K.
- iii. Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2019, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, për të ardhurat nga punësimi për periudhën 15.7.1981 – 1.10.1991, në Ndërmarrjen e Përpunimit të Drurit në Laç dhe për periudhën 1.10.1991 – 28.2.1996, në Fabrikën e Letrës Laç.
- iv. Vërtetim për bazën e vlerësueshme, datë 15.7.2020, sipas të cilit për periudhën mars 1996 – 1998 nga verifikimet e kryera nga DRSSH-ja Lezhë për shtetasin P. N. rezulton që nuk ka bordero.

Vlerësimi i trupit gjykues

51. Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjithë materialin e administruar në lidhje me këtë pikë, shpjegimet, argumentimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson, si vijon:
52. Duke mbajtur në konsideratë edhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me burimet e kursimit të shumës së dhuruar bashkëshortit të subjektit prej babait – që është shprehur mbi kursimet e familjes së origjinës së bashkëshortit³⁴, si një investim i përbashkët dhe të konsiderimit prej tyre të një ekonomie të përbashkët – të përshtetura dhe të trajtuara në të ardhurat e shtetasit Ll. K., përpara lidhjes së martesës në vitin 1998, janë përllogaritur në analizën financiare të kësaj shume. Rrjedhimisht, nuk mund

³⁴ Pasuria nr. 2, burimi 2. 2, par. 30.

të merren në konsideratë edhe në analizimin e burimit të të ardhurave për dhënien e huas në vlerën 27,000 euro.

53. Nga vërtetimi i lartpërmendur, për shtetasin P. N., deri në shkurt të vitit 1996, rezultojnë burime të provuara për një shumë të ardhurash prej 175,652 lekësh. Nisur nga këto të dhëna Komisioni ka përllogaritur po ashtu – edhe për periudhën që nuk ka qenë e mundur gjetja/paraqitja e borderove përkatëse (sipas vërtetimit të sipërcituar, nga marsi 1996 – në dhjetor 1998) – si të realizuara të ardhura në të njëjtën/in masë/nivel page, (në mungesë të provës alternative), që rezultojnë në shumën prej 495,864 lekësh (175,652 + 320,212). Ndërkohë, nëse do të përllogariteshin edhe shpenzimet e jetesës në masën 70 % të këtyre të ardhurave, atëherë mundësia e kursimit të shtetasit P. N., do të rezultonte në vlerën 148,760 lekë. Vlerësohet se kjo vlerë edhe pse e përmirëson/rrit masën hipotetike të kursimeve të realizuara dhe të ruajtura deri në vitin 2005, nuk ndikon në mënyrë të konsiderueshme, në raport me kursimet totale që u kanë mundur huadhënësve, kalimin e shumës prej 27,000 euro, në favor të familjes së subjektit.
54. Në konkluzion, lidhur me këtë burim, trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet e Kolegjit të Apelit mbi rrethana të ngjashme – sikurse janë cituar edhe nga subjekti i rivlerësimit – dhe duke konsideruar se nuk duhet tejkaluar perimetri i objektit të vlerësimit të Komisionit, i cili në rastin konkret është burimi i ligjshëm i personit tjetër të lidhur, për sa i përket shumës së përfituar (si huamarrje) dhe të përdorur nga subjekti i rivlerësimit, pra, shuma prej 27.000 euro, pa kaluar në analizën financiare e përllogaritje të pasurive, investimeve apo shpenzimeve të tjera. Kjo analizë mund të tentohet të realizohet – përpos vështirësive teknike për të mbledhur të dhëna të sakta, ndër vite, për të kryer një analizë financiare të mirëfilltë, për një person/familje që nuk ka qenë subjekt deklarues – në mënyrën më të gjerë të mundshme vetëm nëse do të gjendeshim përballë një pasurie, mbi të cilën, në bazë të *indicieve* apo denoncimeve/informacioneve konkrete, do të kishte dyshime të arsyeshme se ishte një pasuri e fshehur – por nuk është ky rasti.
55. Trupi gjykues, për sa më lart, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, çmon se burimi i shumës së marrë hua prej 27.000 euro – i deklaruar rregullisht ndër vite si huamarrje dhe si pagesa/shpenzime të kthimit të saj – duhet të konsiderohet i ligjshëm, për sa kohë kjo shumë mbulohet dhe tejkalohet nga burime të ligjshme, sipas parashikimeve të dispozitave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016.

2.3 Lidhur me kursimet e realizuara nga z. E. K.

56. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E. K. ka depozituar në Bankën e Shqipërisë – në formën e bonove të thesarit – shumën prej 400,000 lekë, konkretisht përgjatë periudhës nga 11.12.2003 – 8.12.2005, me burim të deklaruar nga kursimet.
57. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar shumën e lartpërmendur si një nga burimet e përdorura për blerjen e kësaj pasurie (nr. 2 - apartamentit në analizë), dhe konkretisht, arkëtimin nga bonot e thesarit në datën

8.12.2005, në shumën prej 397,013 lekësh. Subjekti i rivlerësimit këtë rrethanë e ka shpjeguar, si vijon: “Në vitin 2005, shumën 397,013 lekë e tërhequr në muajin dhjetor datë 8, nga bonot e thesarit, ne kemi harruar ta deklarojmë gjendje cash në fund të vitit 2005. Ky gabim në plotësimin e deklaratës në këto vite, ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit të mjaftueshëm për mënyrën e plotësimit të formularit të deklaratës së interesave periodik vjetor”.

58. Trupi gjykues çmon se – duke mbajtur edhe këtu në konsideratë jurisprudencën e konsoliduar tashmë të Kolegjit të Apelit, si dhe aspektin sasior të shumës në fjalë, të ndërthurura këto me rrethanat e tjera specifike – ndonëse gjendja prej 400,000 lekësh, rezulton me burime të ligjshme dhe e zotëruar në mënyrë legjitime dhe të verifikueshme, deri në datën 8.12.2005, më pas – për sa kohë nuk është deklaruar si një gjendje cash në banesë, në fund të vitit 2005 – nuk mund të konsiderohet si një shumë e përdorur për pagesën e pretenduar, pasi nuk mund të përjashtohet mundësia e shpenzimit të kësaj shume më herët, brenda vitit 2005. Për sa më lart, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, duke munguar prova e vijueshmërisë së posedimit edhe pas datës 1.1.2006, i të hollave të tërhequra në datën 8.12.2005, nuk provohet dhe as nuk mund të prezumohet disponibiliteti konkret i tyre deri në momentin që pretendohet se janë përdorur, si burim për blerjen e kësaj pasurie (nr. 2).
59. Nga analiza financiare e kryer nga Njësia Ligjore e Komisionit, ka rezultuar se – duke marrë në konsideratë të ardhurat sipas vlerësimeve të lartpërmendura, për secilin burim të deklaruar për blerjen e apartamentit në fjalë, si dhe duke përlllogaritur kryerjen e shpenzimeve, investimeve dhe të likuiditeteve gjendje në bankë – ka rezultuar se përgjatë vitit 2006, subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën - 436,848 lekë.
60. Në tabelën më poshtë është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur analiza financiare e viteve 2005, 2006 dhe 2007, periudha në të cilat janë kryer pagesat për likuidimin e çmimit total, për blerjen e apartamentit në analizë (nr. 2) nga subjekti i rivlerësimit:

Viti	2005	2006	2007
Pagesat e kryera për blerjen e apartamentit	-3 432 513	-3 030 724	-1 813 650
Të ardhura nga subjekti dhe bashkëshorti	1 151 761	1 145 555	1 057 304
Dhuruar nga babai i bashkëshortit	-	3 000 000	-
Hua nga motra e bashkëshortit	2 685 019	630 885	-
Shpenzime të vitit	-248 216	-273 893	-779 266
Gjendja e likuiditeteve në fillim të vitit	400 000	91 503	2 000 175
Gjendja e likuiditeteve në fund të vitit	-91 503	-2 000 175	-28 705
Rezultati	464 548	-436 848	435 859

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

61. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre, është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
62. Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm dhe përfundimtar ka rezultuar një bilanc negativ në shumën prej 436,848 lekësh, si rrjedhojë e një pamjaftueshmërieje financiare të konstatuar në vitin 2006, për shkak të mosmarrjes në konsideratë të shumës së tërhequr nga sistemi bankar më 8.12.2005 dhe të padekluarur si gjendje *cash* në fund të këtij viti.
63. Në përfundim, trupi gjykues pas analizimit të provave të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se – duke e parë çështjen nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit dhe duke e vlerësuar në tërësinë e saj kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi – pamjaftueshmëria financiare e lartpërmendur (duke mbajtur në vëmendje edhe rrethanën e mosdeklarimit të gjendjes *cash*), sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet vjetore, në vetvete, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra, të znj. Altina Nasufi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84.2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

64. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, është përcjellë në Komision një raport për subjektin e rivlerësimit, nr. *** prot., datë 2.11.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, zj. Altina Nasufi.
65. Më pas, me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2018, DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit një informacion shtesë, në vijim të të cilit, trupi gjykues është njohur me materialet e klasifikuara, si dhe janë kërkuar dhe administruar disa dosje dhe akte profesionale që mund të lidheshin me *indiciet* e referuara në dokumentacionin e lartpërmendur.
66. Gjithashtu, me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2019, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së përditësimin e raportit në fjalë dhe deklasifikimin e tij. Me shkresën e datës 15.6.2020, DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin e dytë me nr. *** rep. dhe nëpërmjet këtij raporti ishte ndryshuar përfundimi i mëparshëm i Grupit të Punës, duke konkluduar për papërshtatshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina H. Nasufi, për shkak të disa dyshimeve të ngritura, në bazë të informacioneve të pakonfirmuara. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2020, DSIK-ja i ka komunikuar

Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar pjesërisht në datën 17.6.2020, me vendimin nr. ***, të KDZH-së.

67. Në vijim të analizimit të dy dosjeve³⁵ profesionale të administruara përgjatë hetimit administrativ të pavarur të kryer nga Komisioni – të cilat janë përshkruar dhe trajtuar në mënyrë më të zgjeruar në pjesën përkatëse të kapitullit të rivlerësimit të aftësive profesionale - nuk kanë rezultuar fakte të mjaftueshme që të mund të mbështesnin dhe të konfirmonin ndonjë përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të znj. Altina Nasufi, me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar, në bazë të të cilave edhe Komisioni do të mund të arrinte në të njëjtat konkluzione që kishte arritur DSIK-ja.
68. Në këto kushte, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, *indiciet* dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, nuk u gjetën elementë të mjaftueshëm që të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

69. Komisioni në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLGJ –së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në:
 - a. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGj-ja, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. ***prot., datë 11.4.2019.
 - b. Informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncime të publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.
 - c. Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me analizën e aftësive profesionale kryer nga KLGj-ja

70. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga KLGj-ja është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) në pesë dokumente ligjore të përzgjedhura, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.
71. Nga analiza e KLGJ –së, mbi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet, si vijon:
 - a. Saktësia e formularit të vetëdeklarimit, i cili paraqitet i plotë sipas shtojcës të ligjit, pa mangësi e kundërthënie.

³⁵ Njëra me palë te pandehur XH. M. (vendimi nr. ***- dosje e administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër) dhe tjetra me palë B. Ç. Lidhur me vendimin nr. ***, dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

- b. Subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi në 10 vitet e fundit, në periudhën tetor 2003 – nëntor 2013, ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ndërsa nga nëntori 2013 – dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Administrative të Apelit Tiranë.
 - c. Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore, lidhur me ngarkesën sasiore për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, ka qenë e lartë.
 - d. Në 3 vitet e fundit, ka deklaruar edhe pesë trajnime të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës “*Acess to Justice*”, i organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Hollandë dhe Matrapatrol, Hollandë.
72. Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, janë të llojit vendim gjyqësor, nga ku dy vendime të vitit 2014, ndërsa një vendim i përket vitit 2016.
73. Komisioni në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLGj-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
74. Në përfundim të analizimit të tre akteve të përzgjedhura nga subjekti, KLGj-ja në mënyrë të përmbledhur ka konstatuar se:
- i. Në një rast gjykimi ka zgjatur katër muaj e 6 ditë – përtej afatit 30 ditor të përcaktuar nga pika 2, e nenit 48, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
 - ii. Të tre vendimet paraqiten të standardizuara në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës, si dhe përzgjedhja e vendimeve nga subjekti ka qenë e tillë që referon në gjykime me objekt dhe procedurë të ndryshme, me qëllim arritjen e konkluzionit më të qartë rreth aftësive profesionale.
 - iii. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, është konstatuar zgjatja e gjykimeve përtej afatit 30 ditor, të lartpërmendur, por nuk janë evidentuar problematika të tjera.
 - iv. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se janë paraqitur gjithsej 12 ankesa në ish-Inspektoratin e KLD-së (8 ankesa në vitin 2014, 1 ankesë në vitin 2015 dhe 3 ankesa për vitin 2016), nga të cilat 8 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 4 ankesa janë arkivuar me arsyetimin se ato janë ankesa të përsëritura.
 - v. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Altina Nasufi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.
75. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota.
76. **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**
- a) Etika në punë*
- Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtares Altina Nasufi.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, si dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.

77. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor nuk ka të dhëna për mënyrën direkte të komunikimit të subjektit të rivlerësimit zj. Altina Nasufi, me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve, sipas parashikimeve në ligjin nr. 49/2012.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale që parashikon ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 11 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, në total ka marrë pjesë në 15 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare.

RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE NGA KOMISIONI

78. Komisioni në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet e publikut dhe nga organet ligjzbatuese, si dhe duke analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

79. Rezulton se pranë Komisionit – bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 – për subjektin e rivlerësimit, zj. Altina Nasufi, janë paraqitur nga publiku 34 denoncime, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të këtyre të fundit dhe të informacioneve të tjera të marra nga Komisioni, nëpërmjet organeve ligjzbatuese, bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa dosje gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, zj. Altina Nasufi.

80. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku, ka konstatuar se në përmbajtjen e pjesës më të madhe të tyre nuk janë evidentuar *indicie* apo elementë konkretë që mund të çonin në ndonjë shkelje procedurale apo në cenim të të drejtave të palëve. Ndërsa lidhur me disa prej denoncimeve në të cilat janë gjetur *indicie* apo elementë konkretë, janë kryer hetime të thelluara, duke administruar dosje hetimore dhe/ose gjyqësore, vendime specifike, si dhe akte të tjera, që ndërthureshin me referencat apo informacionet e denoncimeve në fjalë. Në rezultatet e hetimit që i janë njoftuar subjektit të rivlerësimit, veç të tjerash, janë përfshirë edhe disa denoncime nga publiku, lidhur me të cilët, pas një hetimi të thelluar, Komisioni kishte kristalizuar disa gjetje që i janë bërë me dije subjektit të rivlerësimit, duke e ftuar për të paraqitur shpjegimet përkatëse.

Lidhur me denoncimin nr. * prot., datë 15.2.2016 , të paraqitur nga shtetasi B.Ç.**

81. Denoncuesi B. Ç. është ankuar duke akuzuar subjektin e rivlerësimit për dhënien e një vendimi të padrejtë dhe për një proces të parregullt ligjor.

82. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare/relatore në çështjen pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për të cilën është dhënë vendimi nr. ***, datë 7.2.2018, i cili ka ndryshuar vendimin nr. ***, datë 16.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjjirokastër, duke e vlerësuar jo të drejtë dhe të pa bazuar në ligj, sepse zgjidhja e kontratës së shërbimit publik është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi kërkesa për kthimin në detyrë të punonjësve të policisë së shtetit, sipas jurisprudencës, nuk gëzon mbrojtje gjyqësore., Rrjedhimisht, kërkimi i vetëm i paditësit, si pasojë e paligjshmërisë së vendimit të përjashtimit të tij nga Policia e Shtetit, është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit e cila ka pranuar pjesërisht padinë objekt shqyrtimi.

83. Gjithashtu, lidhur me këtë çështje Komisioni është vënë në dijeni edhe të disa informacioneve të përcjella nga organet ligjzbatuese – në vijim të të cilave anëtarët e trupit gjykues janë njohur me disa dokumente që përmbanin informacione të klasifikuara, por këto të fundit nuk përputhen dhe nuk kanë gjetur ndonjë mbështetje në faktet e konstatuara nga Komisioni. Ky konkluzion arrihet jo vetëm për faktin që pala ndërgjyqëse (B. Ç.) ka përcjellë në Komision denoncimin në fjalë, duke shprehur pakënaqësi dhe akuza ndaj vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit (rrethanë kjo që deponon qartazi për inekzistencën e ndonjë favorizimi të denoncuesit nga subjekti), por edhe duke konsideruar përmbajtjen argumentuese të vendimit në fjalë, nga ku nuk konstatohen shkelje të tilla që mund të kenë deformuar realitetin ose të kenë favorizuar shtetasin B. Ç. Përkundrazi, duke hedhur një vlerësim të përgjithshëm mbi vendimmarrjen në analizë – kjo në rrugë përjashtimore (dhe për shkak të veçantisë së rrethanave që kanë aktivizuar Komisionin) – mund të konstatohet me lehtësi se shtetasi B. Ç. nuk ka qenë aspak i favorizuar nga kjo vendimmarrje, madje duket se as nuk ka përfituar çka i takonte sipas vlerësimit të kryer nga Gjykata Administrative e Apelit (e cila në vendimin nr. 433/2018, ndonëse i jep të drejtë paditësit, nuk shprehet mbi dëmshpërblimin – për shkak të mosparaqitjes nga ana e tij në padi, të kërkesës lidhur me dëmshpërblimin e cituar edhe në denoncimin *de quo*).

84. Një tjetër pikë në ankesën e paraqitur nga ky denoncues, lidhet me mospasjen dijani, (pra, mungesën e njoftimit të shtetasit B. Ç. nga gjykata), mbi datën e caktuar të seancës gjyqësore, datë 7.2.2018, pasi më datë 28.2.2018, i ishte njoftuar vetëm vendimi i marrë, pikërisht, në datën 7 shkurt, por jo data e caktuar për seancën gjyqësore. Komisioni, në vijim të hapave hetimor, pasi ka administruar në datën 17.6.2020, nga Gjykata Administrative e Apelit, procesverbalin e seancës së datës 7.2.2018, ka konstatuar se aty nuk përshkruhej asgjë lidhur me njoftimin apo jo të palëve dhe/ose mbi ushtrimin ose jo të të drejtave të palëve, në prag të kësaj seance gjyqësore. Më tej, Komisioni iu drejtua Gjykatës Administrative Gjirokastër, si dhe Gjykatës së Lartë për administrimin e të gjithë dosjes, përfshirë aty edhe njoftimet për palët, me qëllim evidentimin lidhur me caktimin e datës së seancës gjyqësore të zhvilluar në datën 7.2.2018.
85. Me shkresën nr. *** prot., datë 17.6.2020, Gjykata Administrative e Apelit vuri në dispozicion kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore, dy fletë, që i përkisnin çështjes në fjalë, Gjykata e Lartë me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2020, gjithashtu vuri në dispozicion fashikullin e çështjes gjyqësore në të cilën përfshihet praktika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.
86. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, si më lart, konstatohet se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kryetares së trupit gjykues ka hartuar relacionin për çështjen administrative me nr. ***, regjistri themeltar, datë 21.3.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse paditës B. Ç. dhe palëve të paditura, Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Evidentohet se relacioni i hartuar nga subjekti i rivlerësimit, ka të përcaktuar rregullisht datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi.
87. Nga sa më lart është konstatuar se në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit bazuar në ligjin 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, neni 49, ka urdhëruar rregullisht njoftimin e palëve “Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi”, duke përcaktuar se çështja do të shqyrtohet në dhomë këshillimi në datën 7.2.2018, ora 10:05. Gjithashtu, ka urdhëruar sekretarinë gjyqësore, sipas procedurave, për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit, me sqarimin se deri në 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, palët kanë afat të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim.
88. Pjesë e dosjes së administruar ishte edhe akti i njoftimit të shpalljes së seancës gjyqësore, datë 23.1.2018, nga ku rezultoi i regjistruar akti me nr. 31107-01260-86-2016, që i përket palëve ndërgjyqëse B. Ç. dhe Drejtorisë së Policisë dhe Migracionit me shënimet përkatëse të përbërjes së trupit gjykues, datës së seancës, ora dhe vendi i zhvillimit. Për rrjedhojë, referuar ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, neni 49, rezulton se rregullisht nga subjekti i rivlerësimit është kryer njoftimi me shpallje, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes 15 ditë përpara, pra, në datën 23.1.2018. Pra, sikurse rezulton edhe nga sa më sipër, gjykimi në dhomën e këshillimit është zhvilluar në datën 7.2.2018. Nga sa më sipër, ndryshe nga sa pretendon denoncuesi,

rezulton se njoftimi i palëve ndërgjyqëse në datën 23.1.2018, është kryer brenda afatit 15 ditor të parashikuar nga ligji.

89. Ndërkohë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga denoncuesi por edhe nga aktet e administruara nga Komisioni, nuk rezulton që denoncuesi të ketë patur një përfaqësues me prokurë, sikurse ai shprehet në denoncimin e tij – lidhur me mosnjoftimin e seancës.
90. Për sa i takon objektit të padisë “shpërblimin e pagës që nga data 4.12.2015 e në vazhdim” rezulton që kjo kërkesë të jetë shtuar nga pala paditëse në datën 10.2.2016 në seancën e zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Bazuar në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civil, gjykata e ka pranuar kërkesën e palës paditëse dhe sipas procedurës ka njoftuar palët e tjera. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me vendimin nr. ***, datë 16.2.2016, ka rrëzuar padinë e ngritur nga pala paditëse B. Ç. Gjykata Administrative e Apelit, pas shqyrtimi të çështjes, ka vendosur: ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 16.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në këtë mënyrë: pranimin e pjeshëm të padisë – shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 16.10.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për Kufirin dhe Migracionin, të vendimit nr. ***, datë 4.1.2015, të Komisionit të Apelit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe të urdhrin nr. ***, datë 7.12.2015 të Drejtorit të Policisë së Shtetit – rrëzimin e padisë për pjesën tjetër si të pa bazuar në prova dhe në ligj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

91. Lidhur me pretendimet e denoncuesit të lartpërmendur dhe të gjetjeve apo konstatimeve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shprehur qëndrimin e saj, si vijon:
 - i. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se relacioni i hartuar nuk ka të shënuar datën kur është hartuar, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se përgatitja e relacionit ka një zgjatje në kohë dhe është e lidhur me studimin e dosjes, si dhe data e hartimit të relacionit nuk është element detyrues formal i këtij akti procedural sipas dispozitave të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
 - ii. Për sa i takon faktit dhe konstatimit se në këtë vendim nuk është shprehur mbi dëmshpërblimin e kërkuar nga paditësi “[...] *Shpërblimin e pagës që nga data 4.12.2015 e në vazhdim,*” subjekti ka shpjeguar se instrumenti ligjor procedural që vë në lëvizje Gjykatën e Apelit është ankimi, akt të cilin Gjykata e Apelit e merr në shqyrtim në dy drejtime – nga pikëpamja formale dhe nga pikëpamja përmbajtësore. Për rastin konkret, të gjitha dispozitat procedurale me fuqi ligjore në kohën e gjykimit në apel, kanë gjetur zbatim në marrjen e vendimit nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi referuar përmbajtjes në tërësi të ankimit të paraqitur nga paditësi B. Ç., nuk rezulton që prej tij të jetë kërkuar shpërblimi i pagës që nga data 4.12.2015 dhe në vazhdim, në ankimin e bërë. Është kjo arsyeja që Gjykata e Apelit Administrativ ka disponuar me rrëzimin e padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në prova dhe në ligj .
 - iii. Gjithashtu, përgjatë seancës dëgjimore, subjekti ka shpjeguar se përshkrimi i kërkesës së dëmshpërblimit si një nga zërat e kërkesë padisë, të listuara në kopertinën e fashikullit të çështjes në fjalë, lidhej me kërkesat e paraqitura nga paditësi B. Ç., në shkallën e parë

dhe jo nëpërmjet ankimit në apel. Në këtë mënyrë subjekti konfirmoi rrethanën e mosparaqitjes së kërkesës për dëmshpërblim, në apel (kërkesë që ndërkohë kishte rënë në dekadencë, pasi konsiderohej se apeluesi ndaj saj kishte hequr dorë) dhe, për rrjedhojë, kjo qartësonte pamundësinë procedurale të gjykatës për t'u shprehur përtej kërkesave/kufijve të ankimit/apelimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

92. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, lidhur me pretendimet e denoncuesit në fjalë, por edhe nga analizimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe përgjatë seancës publike, Komisioni arrin në konkluzionin se nuk kanë rezultuar shkelje procedurale, mungesë arsytimi apo arsyetim të dobët, ose problematika të tjera që lidhen me aftësitë profesionale të subjektit, për sa i përket kësaj çështje. Veprimet procedurale dhe spektri vendimmarrës në këtë rast çmohen se kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në momentin e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes mbi çështjen në fjalë dhe konkretisht në respektim edhe brenda kornizës ligjore të përcaktuar nga nenet 454, 459 dhe 465 të Kodit të Procedurës Civile, të aplikueshëm edhe në këtë rast. Gjithashtu, nuk janë konstatuar elementë që mund të evidentonin ndonjë konflikt të mundshëm interesi përgjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë apo shkelje etiko-profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me çështjen penale me nr. *, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër**

93. Në vijim të informacioneve të klasifikuara dhe të disa *indicieve* për të cilat Komisioni është vënë në dijeni, është kërkuar dhe administruar materiali i dosjes së çështjes së lartpërmendur – e cila është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi – me objekt veprën penale të “kundërshtimit të punonjësit që kryen një funksion publik”, të kryer nga shtetasi Xh. M.
94. Nga analizimi i përmbajtjes së dosjes në fjalë – ndonëse janë gjetur elementë të pjesshëm që mund të përkojnë në mënyrë të tërthortë me dinamikën e ngjarjeve të përshkruara nga informacionet e sipërcituara – lidhur me aspektin procedural, si dhe me vendimmarrjen në përgjithësi, nuk janë konstatuar parregullsi domethënëse në veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni ka konstatuar se dënimi final i dhënë në përfundim të kësaj çështje përkon me rrethanat faktiko-ligjore dhe me konkluzionet përfundimtare, si dhe me kërkesën e paraqitur nga prokurori i çështjes. Kjo përputhje qëndrimesh konstatohet si në lidhje me cilësimin e veprës penale, ashtu edhe në respektimin kriterëve ligjore për caktimin e masës së dënimit me gjobë të shtetasit Xh. M. nëpërmjet vendimit nr. 100, datë 1.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër nga subjekti i rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

95. Lidhur me dosjen penale, nr. *** vendimi, datë 1.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në ngarkim të shtetasit Xh. M., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “kundërshtimit të punonjësit të rendit publik” e parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal, Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ dhe me dosjen përkatëse, veç të tjerash, ka shpjeguar sa vijon:

96. Kjo çështje është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër në datën 7.3.2013. Gjykimi i kësaj çështje penale, është bërë mbi procedurën e gjykimit të zakonshëm me marrjen në shqyrtim gjyqësor të provave të kërkuara si nga organi i akuzës ashtu edhe nga i pandehuri. Gjatë gjithë këtij procesi gjyqësor, i pandehuri ka mbajtur qëndrim mohues ndaj akuzës.
97. Në mbyllje të këtij gjykimi, në konkluzionet përfundimtare me shkrim të shprehura edhe verbalisht para gjykatës, në seancën gjyqësore të datës 23.9.2013, prokurori ka kërkuar: “Deklarimin fajtor të të pandehurit Xh. M. për kryerjen e veprës penale të *‘kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik’* parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal dhe bazuar në këtë dispozitë, dënimin e tij me 60.000 Lekë gjobë”.
98. Kundër këtij vendimi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit asnjë prej palëve në proces gjyqësor dhe sipas shënimeve të bëna nga Kancelaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ky vendim ka marrë formë të prerë.

Vlerësimi i trupit gjykues

99. Komisioni, në vijim të analizës dhe të shqyrtimit të fakteve, rrethanave dhe dokumenteve të sipërpërmendura, vlerëson se edhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit ka vepruar në respektim të dispozitave ligjore duke përmbyshur detyrën, për sa kohë nuk është evidentuar ndonjë shkelje konkrete dhe as nuk ka elemente që mund të çojnë në dyshime të arsyeshme për ndonjë favorizim të mundshëm të të pandehurit/dënuarit. Gjithashtu, nga hetimi administrativ nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer ndonjë shkelje procedurale, apo ndryshim të pabazuar të cilësimit të veprës penale, ose të ketë dhënë një vendim të paarsyetuar apo me arsyetim të dobët dhe/ose kontradiktor.
100. Komisioni arrin në konkluzionet e mësipërme bazuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjes në fjalë dhe të veprimeve procedurale të kryera në rastin konkret, si dhe nga analizimi i përmbajtjes së vendimit përfundimtar, në raport me kuadrin faktiko-ligjor dhe përputhshmërinë e fakteve me akuzat e ngritura. Gjykata, nëpërmjet vendimit në fjalë në pjesën arsyetuese të tij, është shprehur se e ka gjetur të bazuar akuzën e ngritur nga prokurori, me arsyetimin se:
 101. [...] I pandehuri Xh. M. ka konsumuar tërësisht elementët e figurës së veprës penale të *“Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik”* të parashikuar si krim nga neni 236/1 i Kodit Penal. Me veprimet e tij të kundërligjshme ai ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt dhe normale të forcave të policisë së shtetit të përcaktuara në ligjin *“Për policinë e shtetit”*. Në anën objektive kjo vepër penale është konsumuar me anë të veprimeve aktive kriminale që kanë konsistuar në kundërshtimin e punonjësve të policisë së rendit publik për t’i penguar ata në kryerjen e detyrave të tyre funksionale sipas ligjit dhe konkretisht shuarjes së konfliktit të nisur në një zonë me popullsi të konsiderueshme në vendngjarje. Pretendimi i të pandehurit se urdhri i punonjësve të policisë është i paligjshëm, pasi ai është pronar i rrugës, është i pabazuar pasi për të ekzistuar kjo vepër penale nuk verifikohet ligjshmëria e urdhrin apo pretendimi i të pandehurit për pronësi, por mjafton kundërshtimi me veprime aktive, kur policia e shtetit është në përmbyshje të detyrave të saj të ligjshme [...].
102. Kundër këtij vendimi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit asnjëra prej palëve në proces gjyqësor dhe sipas shënimeve nga Kancelaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ky vendim ka marrë formë të prerë.

103. Për sa më lart, trupi gjykues çmon se në rastin në fjalë nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale, favorizim, mosaplikim apo keqaplikim i dispozitave ligjore dhe, për rrjedhojë, i gjen të pabazuara informacionet, *indicet* apo konkluzionet e përcjella dhe të bëra me dije Komisionit edhe lidhur me këtë çështje. Gjithashtu, nuk kanë rezultuar elementë që mund të evidentonin ndonjë konflikt të mundshëm interesi përgjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë apo shkelje etiko-profesionale nga subjekti i rivlerësimit.
104. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet e bëra nga KLGj-ja, lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit – problematikat që kanë rezultuar lidhur me afatet e përfundimit të shqyrtimeve gjyqësore, nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale.
105. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve ligjore që përcaktojnë pragun e kualifikimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 29.7.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona Sanxhaktari
Kryesuese/Kundër

Lulzim Hamitaj
Relator

Pamela Qirko
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka